



Republika e Kosovës * Republic of Kosova

Komuna * Municipality

Hani i Elezit



Date 11.10.2019

Nr.09/ 9268 /2019

KONTRATË SHËRBIMI

KOMUNA HANI I ELEZIT përfaqësuar nga Zyra e Prokurimit me Zyrтарin Përgjegjës Xhevdet Bushi, MSc. (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Kompania e Sigurimit "SIGKOS" SH.A. nga Prishtina me NRB: 70249109 NRF 600140793 me Numër unik të biznesit 811292979 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), përfaqësuar nga **Lorik Gashi** me autorizim nga operatori ekonomik në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për: "Sigurimi dhe regjistrimi i veturave të komunës, QKMF-se, zjarrfikësve etj" me numër Identifikues: KKHE-19-032-236

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë : "Sigurimi dhe regjistrimi i veturave të komunës, QKMF-se, zjarrfikësve etj".

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 11.10.2019 dhe përfundon me 10.10.2020.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 2 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimit është komuna Hani i Elezit.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë : **9,376.76 €**; Nëntë mijë e Treqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e shtatëdhjetë e gjashtë cent.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet më së shumti 30 ditë nga data e pranimit të faturës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i Furnizimeve/**shërbimeve** duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet të kërkuara e të parashtruara në Dosjen e Tenderit. Në rast se të kundërtën nuk do të bëhet **pranimi i furnizimit/shërbimit**.

Neni 7 Garancioni

7.1 Ekzekutimi i kontratës do të bëhet brenda afati të përcaktuar në nenin 1. Pika 1.2 nga data e nënshkrimit të kontratës i siguruar me siguri të ekzekutimit të kontratës në vlerë prej 10 % të vlerës së kontratës në afat prej trembëdhjetë (13) muajve dhe për çdo mos-kryerje të shërbimit sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, dhe do të detyroheni njëanshëm të bëjmë shkëputjen e kontratës në fjalë dhe të merr masa ligjore konform LPP-së.

7.2 ***Obligimi i kontraktuesit është bën shërbimit e sigurimit dhe regjistrimit të veturave të theksuara në përshkrim të çmimeve.***

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin ***[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]*** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së ***[furnizimeve/shërbimeve]*** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin

Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në **Gjykata kompetente** në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **[Shqipe]**² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Lorik Gashi	Emri:	Xhevdet Bushi
Pozita:	Përfaqësues me autorizim	Pozita:	Shef i Zyrës së Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.10.2019	Data:	11.10.2019
Vula:		Vula:	

² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.